REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 429/25 Dt. 18.07.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar mes Komunës së Prizrenit dhe Universitetit "Ukshin Hoti", 01 nr. 409/25 të datës 09.07.2025 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve financiare

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin e projektit që ka për qëllim mbështetjen e Universitetit "Ukshin Hoti" në bashkëorganizimin dhe mbarëvajtjen e Shkollës Verore Ndërkombëtare 2025, e cila do të mbahet nga data 30 korrik 2025 deri me 08 gusht 2025, i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 2 paragrafi 2.1 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar mes Komunës së Prizrenit dhe Universitetit "Ukshin Hoti", 01 nr. 409/25 të datës 09.07.2025, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumën prej 10.000, 00 € (dhjetë mijë euro).

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëpunimit e nënshkruar mes Komunës së Prizrenit dhe Universitetit "Ukshin Hoti", 01 nr. 409/25, të datës 09.07.2025.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
- Universitetit "Ukshin Hoti",
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.